



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 1156, datë 24.12.2020

P Ë R

**PËRCAKTIMIN E TË ARDHURAVE TË GJENERUARA
NGA TARIFAT QË PAGUHEN NË ZONAT E MBROJTURA,
TË MASËS DHE KRITEREVE TË PËRDORIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 58, të ligjit nr.81/2017, "Për zonat e mbrojtura", me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të ardhurat e gjeneruara nga tarifrat vjetore janë të ardhurat nga tarifrat që paguhen për ushtrimin e veprimtarive ekonomike, shoqërore, turistike, kërkimore-shkencore në zonat e mbrojtura, tarifrat që paguhen nga transporti në territoret e tyre, si dhe tarifrat që paguajnë vizitorët e turistët, të cilët vizitojnë këto zona.
2. Të ardhurat e gjeneruara nga tarifrat vjetore administrohen nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (në vijim, AKZM), sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
3. Çdo vit AKZM-ja harton:
 - a) planin e të ardhurave të siguruara nga tarifrat vjetore për aktivitetet e përcaktuara në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
 - b) planin/et financiar/e të përdorimit të të ardhurave të siguruara nga tarifrat.
4. Të ardhurat e gjeneruara nga tarifrat përdoren nga AKZM-ja në masën:
 - a) 60 % për:
 - i. investimet në zonat e mbrojtura;
 - ii. hartimin e planeve të menaxhimit për zonën e mbrojtur mjedisore (në vijim, ZMM) dhe inventarizimit të pyjeve, të kullotave, monitorimin e florës dhe të faunës së egër;

- iii. projektet e pyllëzimit, për përmirësimet, luftimin nga gërryerjet, shtigjet në zonat e mbrojtura, rehabilitimin e habitateve dhe të peizazhit, largimin e menaxhimin e specieve invazive të huaja;
- iv. masat për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri;
- v. ndërtimin e mirëmbajtjen e infrastrukturës brenda zonave të mbrojtura për komunikimin, pritjet malore, gardhimet, për ndërtesat dhe qendrat e vizitorëve (në vijim, QV);
- vi. publikimet, ndërgjegjësimin, edukimin e informimin e publikut të gjerë.

b) 40 % për:

- i. masat për parandalimin dhe luftimin e erozionit;
 - ii. luftimin e sëmundjeve e të dëmtuesve;
 - iii. mbarështimin, ushqimin e sigurimin e kushteve të jetesës për faunën e egër;
 - iv. blerjet e mjeteve të komunikimit e transportit, për mobilimin dhe përmirësimin e kushteve të punës së administratave rajonale të zonave të mbrojtura (në vijim, AdZM) dhe punës në terren;
 - v. përballimin e shpenzimeve për punësime sezonale për aktivitete brenda zonave të mbrojtura;
 - vi. mbështetjen e aktiviteteve tradicionale të komuniteteve lokale.
5. Tarifat vjetore për aktivitetet dhe shërbimet e ofruara në zonat e mbrojtura janë në përputhje me lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Aplikimi i tarifave hyn në fuqi në 1 shtator 2021.
6. Kriteret bazë për përdorimin e të ardhurave të gjenuara nga tarifat janë:
- a) rëndësia e zonës së mbrojtur sipas kategorisë dhe vlerësimit të shkallës së natyralitetit;
 - b) numri i turistëve që vizitojnë zonën, si shprehje e vlerës së zonës;
 - c) interesi i komuniteteve lokale në përfitimin e investimeve;
 - ç) sasia e të ardhurave që arrin të grumbullojë administrata rajonale;
 - d) tregues të performancës në punë e stafit të administratës rajonale.
7. Planifikimi i investimeve për vitin pasardhës, për të gjitha llojet e aktiviteteve në ZMM, që financohen nga të ardhurat e gjeneruara nga tarifat, propozohet nga administrata rajonale e zonave të mbrojtura dhe miratohet nga AKZM-ja, duke mbajtur në konsideratë planin financiar, masën e kriteret e përcaktuara sipas këtij vendimi dhe në planet e menaxhimit për secilën zonë.

8. Drejtori i Përgjithshëm i AKZM-së ngre një grup pune për vlerësimin e propozimit të planit të të ardhurave për AKZM-në brenda muajit dhjetor, duke vlerësuar e përcaktuar projektet që do të zbatohen vitin e ardhshëm, sipas prioriteteve të programit të menaxhimit të ZMM-së dhe kritereve të përcaktuara në pikën 6, të këtij vendimi.
9. Pas miratimit të planit të të ardhurave të gjeneruara nga tarifat, ndarja e përdorimit të të ardhurave të grumbulluara bëhet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, sipas planifikimit dhe projekteve që financohen.
10. Të ardhurat e gjeneruara nga tarifat, sipas këtij vendimi, kanalizohen nëpërmjet llogarisë së thesarit dhe përdoren nga AKZM-ja si të ardhura jashtë limitit mbi bazë të legjislacionit në fuqi.
11. Të ardhurat e akumuluar në llogarinë jashtë thesarit në bankën e nivelit të dytë, me emërtimin “Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave”, gjatë periudhës kohore nga momenti i krijimit të AKZM-së e deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, do të transferohen në llogarinë e të ardhurave të thesarit dhe do të administrohen nga AKZM-ja, në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi.
12. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA


Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACE

**MINISTRI I TURIZMIT
DHE MJEDISIT**

BLENDI KLOSI



Lidhja nr.1

LISTA E TARIFAVE PËR ZONAT E MBROJTURA MJEDISORE

Për veprimtaritë që kryhen brenda zonave të mbrojtura mjedisore, në përputhje me dizpozitat e ligjit "Për zonat e mbrojtura" dhe të akteve të tjera nënligjore në fuqi, paguhet tarifë vjetore, si më poshtë vijon:

1. Tarifa e shërbimit

- a) Angazhimet dhe shpenzimet administrative të AKZM-së vlerësohen si shërbime ndaj të tretëve dhe paguhen nga kërkuesi në formën e tarifës së shërbimeve;
- b) Vlera e tarifës përfshin shpenzimet administrative dhe të gjitha veprimtaritë konkrete të stafit të AKZM-së dhe AdZM-së, gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesës e të kryerjes së shërbimit;
- c) Tarifa e shërbimit e paguar është e pakthyeshme, pavarësisht nga fakti nëse kërkesa miratohet ose jo përfundimisht nga ministri përgjegjës apo drejtori i Përgjithshëm i AKZM-së.

Tarifa e shërbimit për:

- | | |
|---|--------------------------|
| a) dhënien e autorizimeve/lejeve të ndryshme | 5 000 lekë/çdo kërkesë; |
| b) dhënien e të dhënave statistikore, harta, për florën e faunën e egër, e të tjera të kësaj natyre për ZMM | 15 000 lekë/çdo kërkesë; |
| c) kryerjen e ekspertizës në terren | 50 000 lekë/çdo kërkesë. |

2. Tarifat e materialit drusor të rezultuara nga kryerja e punimeve të shëndetësimit apo dhe nga faktorët natyrorë

Të gjitha ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin e ekosistemeve të ndryshme realizohen vetëm në rast se janë parashikuar në planin e menaxhimit ose vijnë si pasojë e emergjencave natyrore dhe të projektit teknik të miratuar nga AKZM-ja. Materiali drusor i rezultuar i shitet në radhë të parë komunitetit, i cili ndodhet brenda territorit të ZMM-së, me qëllim përballimin e nevojave të tyre për ngrohje, gatim a përdorime të tjera vetjake, si dhe subjekteve private brenda zonës, mbi bazën e tarifave të mëposhtme:

a) Për komunitetin:

- i. drutë e zjarrit 500 lekë/mst;
 - ii. asortimentet e lëndës së punimit me koston e prodhimit;
- b) Për subjektet private, të gjitha asortimentet e prodhuara shiten me koston e prodhimit + fitmin, jo më shumë se 15% të koston.

Në rastet kur punimet do të kryhen në pronat private, në bazë të miratimit paraprak nga AdZM-ja, pronari ka të drejtë të veprojë në përputhje me interesat e tij për materialin drusor që do të rezultojë.

3. Tarifat për dhënien në përdorim të sipërfaqeve të ZMM-së (të miratuara konform dispozitave ligjore dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi)

a) Vlera e sipërfaqes së zënë nga ndërtesa/trualli/biznesi:

Për veprimtari ekonomike në zonat e mbrojtura që lidhen me ndërtime për qëllime pushimi dhe argëtimi (kënde lojrash, mjedise sportive, çlodhëse etj.):

- | | |
|----------------------------------|------------------------------|
| - Sipërfaqja me bimësi pyjore | 10 lekë/m ² /vit; |
| - Sipërfaqja me bimësi kullosore | 7 lekë/m ² /vit; |
| - Sipërfaqja pa bimësi | 4 lekë/m ² /vit; |
| - Sipërfaqja ujore | 8 lekë/ m ² /vit. |

Për trojet me pronësi nuk paguhen tarifa.

b) Vlera e sipërfaqes së oborrit që rrethon ndërtesën/truallin/biznesin:

Për veprimtari ekonomike në zonat e mbrojtura që lidhen me ndërtime për qëllime biznesi, komplekse, hotele, restorante, bare, objekte tregtie, pushimi dhe argëtimi (kënde lojrash, mjedise sportive, çlodhëse etj.)

- | | |
|----------------------------------|-------------------------------|
| - Sipërfaqja me bimësi pyjore | 6.5 lekë/m ² /vit; |
| - Sipërfaqja me bimësi kullosore | 4.5 lekë/m ² /vit; |
| - Sipërfaqja pa bimësi | 3 lekë/ m ² /vit; |
| - Sipërfaqja ujore | 5 lekë/ m ² /vit. |

c) Vlera e sipërfaqes për dhënien në përdorim për veprimtari ekonomike:

- | | |
|--|----------------------------------|
| - Objekte tregtie, bare, restorante, hotele | 500 lekë/ m ² /vit; |
| - Qendra ose komplekse pushimi, kurimi dhe turistike | 800 lekë/ m ² /vit; |
| - Vendosje antene të telefonisë fikse, të lëvizshme, televizive, të radiokomunikimit. | 1 000 lekë/ m ² /vit; |
| - Kryerjen e operacioneve shpim-kërkim uji, gazi, naftë, shtrirje tubacionesh në sipërfaqe, ndërtim linje tensioni të lartë, ndërtim kanalesh, hidrokarbure, gjeologjike e minerare, gjermime dhe depozitime materiale në sipërfaqe, ngritje objektësh të ndryshme | 1 000 lekë/m ² /vit. |

ç) Vlera e sipërfaqes për dhënien në përdorim për aktivitetet si:

- kultivimit të bimëve të ndryshme mjekësore, aromatike dhe eterovajore 3 lekë/m²/vit;
- mbarështrimit të faunës së egër 10 lekë/ m²/vit.

4. Tarifat për qëllime të grumbullimit dhe përdorimit të prodhimeve të ndryshme nga ZMM-ja

Në nënzonat e lejuara, sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në planin e menaxhimit

- Fashina, shkarpa	mst	30 lekë;
- Mbeturina pylli të çdo lloji	m ³	40 lekë;
- Thupra të çdo lloji	kv	100 lekë;
- Kucka, rrënjë	kv	250 lekë;
- Cungje	m ³	300 lekë;
- Hunj, bandiera	000/copë	500 lekë;
- Bar për blegtorinë	kv	30 lekë;
- Gjethe për blegtorinë	kv	60 lekë;
- Mbledhja e bimëve mjekësore për qëllime jotregtare	kg	10 lekë;
- Mbledhja e bimëve mjekësore për qëllime tregtare	kg	150 lekë;
- Fryta, fara e sytha	kv	800 lekë;
- Lëvore	kv	600 lekë;
- Kërpudha të ndryshme	kv	5 000 lekë;
- Tartufi	kv	600 000 lekë;
- Boçe të ndryshme	kv	450 lekë;
- Degë të gjelbëra, me dhe pa lule, për buqeta	kv	200 lekë;
- Degë me gjethe për përdorim si fshesa	kv	300 lekë;
- Nxjerrje e grumbullim guri, rëre, zhavori, dheu, hunuesi*	m ³	100 lekë.

a) Kullotja me leje dhe ngritja e staneve:

- Gjerdhët	500 lekë/krerë/vit;
- Të leshtat	100 lekë/krerë/vit;
- Të dhirtat	250 lekë/krerë/vit;
- Derrat	300 lekë/krerë/vit;
- Njëthundrakët	600 lekë/krerë/vit;
- Njëthundrakët (gomar)	200 lekë/krerë/vit;
- Koshere blete	1 lekë/koshere/vit.

5. Tarifat për heqjen e sipërfaqes nga fondi pyjor brenda ZMM-së

Me miratim, sipas dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore në fuqi

- Sipërfaqja me bimësi pyjore 500 lekë/m²;
- Sipërfaqja me bimësi kullosore 250 lekë/m²;
- Sipërfaqja pa bimësi 100 lekë/m²;
- Sipërfaqja ujore 300 lekë/ m².

6. Tarifat për qëllime të ekoturizmit

a) Hyrja e vizitorëve, që nuk janë banorë lokal dhe e mjeteve nëpërmjet pikave të caktuara të aksesit të kontrolluar në parqet e menaxhuar:

- Për vizitorët dhe turistët (me këmbë, biçikleta) 50 lekë/ditë/personi;
- Mjete të çfarëdolloj me kapacitet deri në 5 persona 150 lekë/ditë/mjeti;
- Mjete të çfarëdolloj me kapacitet 6 deri në 10 persona 200 lekë/ditë/mjeti;
- Mjete të çfarëdolloj me kapacitet 11 deri në 20 persona 250 lekë/ditë/mjeti;
- Mjete të çfarëdolloj me kapacitet 21 deri në 50 persona 300 lekë/ditë/mjeti;
- Mjete të çfarëdolloj me kapacitet mbi 51 persona 500 lekë/ditë/mjeti.

b) Përcaktimi i vendeve të aksesit të kontrolluar në parqet e menaxhuara bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës.

c) Kampingje individuale ose kolektive, në çdo formë të ushtruar, lejohet, ekskluzivisht në zonat e dedikuara posaçërisht për këtë qëllim.

- Çadra kampingu deri 3 veta 150 lekë/ditë/çadër;
- Çadra kampingu mbi 4 veta 300 lekë/ditë/çadër;
- Ruleta 500 lekë/ditë;
- Baraka druri 1 000 lekë/ditë/barakë.

d) Filmimi i imazheve të peizazheve, florës dhe faunës së egër apo dhe objekte të ngjashme të territorit të ZMM-së (përveç rastit të ushtrimit të së drejtës gazetareske) paguhet një tarifë e përcaktuar, si më poshtë:

- xhirimet e planifikuara për kinematë 100 000 lekë për çdo minutë deri në 20 minuta dhe 40 000 lekë për çdo minutë të njëpasnjëshme;
- produktet televizive, multimediale ose videoklipe 80 000 lekë për çdo minutë regjistrimi deri në 10 minuta dhe 40 000 lekë për çdo minutë të mëvonshme;

- prodhimin e spoteve reklamuese 40 000 lekë për çdo sekondë të kohëzgjatjes.

Shënim: Tarifat lidhur me autorizimi për shitjen ndaj palëve të treta të produkteve të bëra me imazhe të marra në ZMM janë në vlerë trefish të të drejtave të lartpërmendura.

cc) Përdorimi i fotografive të marra nga ZMM, paguhet tarifa si më poshtë:

Përdorimi i fotografive për:

- botime fotografike (me përjashtim të botimeve shkencore) 15 000 lekë për çdo përdorim;
- revista 3 000 lekë për çdo përdorim;
- reklammat 30 000 lekë.
- e) Për veprimtari të ndryshme në natyrë, në çdo rast 100 lekë/ditë/personi;
- dh) Vëzhgimi i faunës së egër në vendet e posaçme apo dhe në kullat e vrojtimitin deri në 700 lekë/ditë/personi.
- f) Zhytjet profesionale në zona të mbrojtura detare dhe liqenore 2 500 lekë/dita/personi i autorizuar.
- ë) Për aktivitetet e lejuara ekoturistike, çlodhëse, argëtimi dhe sportive të çfarëdolloj karakteri, 1 300 lekë/dita/person.
- g) Për aktivitetet artistike të çfarëdolloj karakteri, 13 000 lekë/dita/për çdo aktivitet.
- h) Për organizimin i garave në zonat e lejuara, sipas dispozitave ligjore në fuqi:
 - automjete të çfarëdolloj 3 500 lekë/ditë/mjeti;
 - motoçikleta të çfarëdolloj 2 000 lekë/ditë/mjeti;
 - biçikleta të çfarëdolloj 200 lekë/ditë/mjeti;
 - vozitje të çfarëdolloj (det+liqen) 1 300 lekë/ditë/mjeti;
 - vozitje me kanoe me 1-3 persona (lumë) 350 lekë/ditë/për çdo kanoe;
 - vozitje me kanoe me 4-9 persona (lumë) 700 lekë/ditë/kanoe;
 - vozitje me kanoe me mbi 10 persona (lumë) 1 200 lekë/ditë/kanoe;
 - deltaplane të çfarëdolloj 1 000 lekë/ditë/mjeti.
- gj) Për ankorimin e varkave/skafeve dhe të mjeteve të tjera të lundrimit:
 - mjete me kapacitet deri në 5 persona dhe të motorave të ujit, 1 300 lekë/ditë/varka;
 - ankorimi i varkave/skafeve me kapacitet mbi 5 persona, 2 000 lekë/ditë/varka;
 - ankorimi i jahteve dhe i mjeteve të tjera të lundrimit, 13 000 lekë/ditë/mjeti.
- h) Për vendosjen e stendave, tabelave, reklamave, shënjave

dhe posterave të çdo karakteri,

1 000 lekë/m².

7. Tarifat për qëllime të kërkimit shkencor dhe të grumbullimit të materialit gjenetik dhe të mostrave

- a) Hulumtuesit, studiuesit dhe specialistët e autorizuar nga AKZM-ja për të kryer kërkime dhe monitorime të karakterit shkencor-studimor, 1 000 lekë/muaj/personi;
- b) Gumbullimi i materialeve gjenetike dhe mostrave:
- | | |
|------------------------------------|---------------------|
| - Për llojet e florës së egër | 3 000 lekë/mostra, |
| - Për llojet e faunës së egër | 10 000 lekë/mostra, |
| - Për minerale etj të kësaj natyre | 33 000 lekë/mostra, |
| - Për gjetjet paleontologjike | 60 000 lekë/mostra, |
| - Për analizat e tokave | 5 000 lekë/mostra. |

NR.PROT. 6148/1
DATË 21.1. 2021

MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCISË KOMBËTARE TË ZONA VE TË
MBROJTURA
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

